

FJALA E DEPUTETIT RAMADAN LIKAJ

E ENJTE 20 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot po flitet për energjinë pa pushim. Në mënyrë të veçantë, nuk dua të kapem ose të diskutoj për ministren, por qysh në krye të herës fillon reklama: “Ngritje. Po bëjmë. Po kthejmë. Ju keni bërë këtë të keqe. Ne kemi bërë këtë të mirë”.

Fatkeqësisht, unë mund të them se ne, opozita, sot këtu, nuk kemi pushtet. Prej nëntë vjetësh pushtetin e keni ju. Por çfarë keni bërë ju për nëntë vjet, e nderuar Ministre? Cilat janë këto arritje? Kujt i shërbejnë këto arritje? Thjesht dhe vetëm një grupi të vogël që menaxhon sot të gjitha postet, të gjitha institucionet dhe po i menaxhon në mënyrën më të shkëlqyer për interesat e pak njerëzve.

Unë them se 70% e energjisë prodhohet në vend. A ndodh kjo në ndonjë vend të botës, që prodhon siç prodhojmë ne, dhe në fund themi: “Nuk kemi energji për qytetarët”? Është për të ardhur keq!

Mbi 500 milionë euro, flisni me shifra, janë investuar gjatë këtyre viteve.

Ku janë këto investime? Sa rezultat kanë këto investime? Sa u kanë shërbyer qytetarëve këto investime, apo thjesht thuhet dhe flitet çdo minutë se këto investime u shërbejnë po juve dhe askujt tjetër? Se unë nuk e di se ku është ky efekt dhe ku jepet ky efekt sot te qytetarët për ta parë këtë rezultat.

Në krahun tjetër flitet se në kohën e qeverisjes suaj, humbjet ishin në masën 40%.

Absolutisht po, se ju keni të drejtë për ta interpretuar, për të folur dhe për ta diskutuar si të doni, se i keni të gjitha pushtetet dhe, për sa kohë i keni të gjitha pushtetet në dorë, ti flet bukur, flet si të duash ti, dhe në kohën tonë thoni: “I kemi ulur humbjet, i kemi reduktuar në 20%”.

Më e keqja, ministrja vazhdon dhe thotë: “Gjatë muajit të kaluar ne kemi arritur të krijojmë një rezervë mbi 5%”. Ku e matët ju, e nderuar Ministre, në një kohë kur çdo matës vjen të paktën një herë në muaj?!

Unë nuk po e them thjesht si një qytetar familjar, por unë flas edhe si biznes. Ata një herë në muaj vijnë ta shohin. Nga ju doli kjo? Si e matët? Si arritët te kjo shifër apo thjesht gabimet... Për t’u matur pulsën qytetarëve, arrini të thoni: ngriti fashat, zbriti fashat. Pse? Realisht i keni në dorë.

Por unë mendoj se ne, si opozitë, duhet të jemi më konkretë, duhet të jemi shumë më të bashkuar. Unë nuk mund të mendoj as edhe për një moment që gjithë kohën drejtuesit, kolegët tanë socialistë, përmendin: “Jo, është turp me të të pa kush, jo po jeni *non-grata*, jo po jeni kështu, jo po jeni ashtu”. Unë po bëj një pyetje. Unë jam deputet që prej një viti e gjysmë. Si nuk doli njeri këtu që një kolegu apo një kolegeje t’i thotë: je kështu, apo je ashtu, por gjatë gjithë kohës vetëm sulm, sulm, sulm ndaj opozitës?

Atëherë, për çfarë mund të flisni ju, në një kohë kur, në vend të merreni me problemet dhe me kërkesat që kanë qytetarët, ju vazhdoni ende të sulmoni opozitën ditë-natë?

Po jap edhe një shembull tjetër. Flitet për karburante dhe për borde, gjë të cilën e kam përmendur edhe herë tjetër: si, more, krijon borde një shtet kur ka ligje? Krijojnë borde për marritë dhe i vendosin çmimet si të duan vetë.

Po jap një shembull të freskët sot. Në Malin e Zi sot karburantin e keni me 1,56 euro, që, po të përkthehen në lekë shqiptare, i bien 1800 lekë ose 180 lekë të rinj. Më thoni pak, ja ku është Mali i Zi, çfarë ndodh te ne?

Me keqardhje ju them se në zonën time, flas edhe për Shkodrën, vetëm të vini të shohni në doganën e Hanit të Hotit se sa makina shkojnë vetëm për t'u mbushur me karburant. Është turp për ne!

Çohen një grup oligarkësh aty, që vazhdojnë të rrisin çmimet përditë, i ulin çmimet përditë, i vendosin përditë dhe në fund të ditës e hanë qytetarët, askush tjetër.

Atëherë, çfarë mund të bëhet këtu? Çfarë mund të themi ne këtu? Thjesht dhe vetëm: vazhdoni retorikën tuaj me luftë të jashtëzakonshme karshi opozitës dhe gjuani në çdo minutë e çdo sekondë!

Absolutisht, kjo gjë është e papranueshme për ju! Nuk mund të shkojë gjatë besoj edhe kjo, se, në fund të fundit, qytetarëve u ka ardhur në majë të hundës.

Unë kam bindjen dhe jam i sigurt se shumë shpejt ata do të ngrihen bashkë me ne për t'i dhënë fund njëherë e përgjithmonë kësaj qeverie. Faleminderit!